



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:096423  
Datë: 04.06.2024  
Numri i dokumentit: 05780451

KPPP.nr. 1537/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit KS “Siguria” Sh.A., me seli në Prishtinë, kundër debitorit Trepça - Ndërmarrje nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 741/15 të datës 03.12.2015, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 04.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

NDËRPRITET procedura në çështjen përmbartimore në mes të kreditorit KS Siguria Sh.A. kundër debitorit Trepça - Ndërmarrje nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), e lejuar sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr. 741/15 të datës 03.12.2015, të Përmbartuesit Privat Flamur S. Bogaj, për shkak të likuidimit të detyrueshëm ndaj debitorit.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Flamur Bogaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania e Sigurimeve SIGURIA Sh.A., ka lëshuar Urdhrin përmbartimor P.nr. 741/15 të datës 03.12.2015, me të cilin ka lejuar përmbartimin mbi bazën e dokumentit faturë nr. 375/12 të datës 20.04.2012, ashtu që është detyruar debitori Trepça - Ndërmarrje nën administrimin e AKP-së, që në emër të borxhit të papaguar nga fatura e lartcekur të paguaj kreditorit shumën prej 208.80 EUR me kamatë ligjore nga data e mos pagesës e deri në përmbushjen definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim duke e kundërshtuar në tërësi Urdhrin për lejimin e përmbartimit me arsyetimin se debitori i është nënshtruar likuidimit të

detyrueshëm dhe ende është në fuqi moratoriumi, rrjedhimisht në bazë të nenit 5 par. 1 të Ligjit 04/L-035 për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së Tyre (këtu e tutje LRNCPT), procedura duhet të pezullohet.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, me arsyetimin se procedura duhet të pezullohet lidhur me procedurat para moratoriumit, ndërsa për rastet kur ndërmarrja pas moratoriumit hynë në raport civilo-juridik, atëherë moratoriumi nuk duhet të vlej.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktvendimin Cpp.nr. 39/2016 të datës 03.02.2016, fillimisht ka pezulluar procedurën në këtë çështje përmbarimore, për shkak të fillimit të likuidimit të detyrueshëm ndaj debitorit.

Duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, Gjykata Themelore në Mitrovicë kishte rihapur procedurën në këtë çështje përmbarimore ashtu që me aktvendimin CPP.nr. 39/2016 të datës 17.06.2020 ka refuzuar në tërësi prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi urdhrin për lejimin e Përmbarimit P.nr. 741/15 të datës 03.12.2015. Në arsyetimin në saj ka theksuar se tanimë nuk ekzistojnë shkaqet për pezullim të procedurës, kjo për faktin se debitori Trepça, tanimë nuk është nën administrimin e AKP-së, pasi që sipas ligjit nr. 05/L për Trepçën, e njëjta është transformuar në shoqëri aksionare.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin Ac.nr. 949/21 të datës 04.04.2022, ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit ashtu që ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë CPP.nr. 39/2016 të datës 17.06.2020 dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje. Në arsyetimin e saj, kjo gjykatë ka theksuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur që ta zhvillojë procedurën në dobi të ndërmarrjes Trepça sh.a, kjo pasi që procedura është iniciuar ndaj ndërmarrjes Trepça nën administrimin e AKP-së.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda në fjalë, në bazë të kompetencës lëndore është transferuar për vendosje pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë.

Gjykata, në rivendosje, pas analizimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se procedura në këtë çështje përmbarimore duhet ndërprerë, andaj edhe u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata fillimisht konstatoi që si debitor në propozimin për përmbarim është caktuar “Trepça Ndërmarrje nën Administrimin e AKP” me NUI 810356932, e cila sipas të dhënave nga regjistri i ARBK-së është ndërmarrje shoqërore nën administrimin e AKP-së, dhe jo “Trepça” Sh.A me NUI 811278747, meqenëse kjo e fundit është themeluar me ligjin përkatës në vitin 2019, pra pas paraqitjes së propozimit. Në anën tjetër, propozimit për përmbarim, i është bashkangjitur fatura nr. 375/12 të datës 20.04.2012, që nënkupton se raporti juridik në mes të kreditorit KS Siguria dhe debitorit Trepça – Ndërmarrje nën administrimin e AKP-së është krijuar para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 05-L-120 për Trepçën.

Në lidhje me këtë, me nenin 14 të ligjit nr. 05-L-120 për Trepçën, paragrafi 1 dhe 2 i saj përcaktohet se *“Pretendimet kreditore ndaj Ndërmarrjes Shoqërore Trepça të dorëzuara në Agjencinë Kosovare të Privatizimit sipas ligjit Nr. 04/L-035 për riorganizimin e Ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin përkatës, trajtohen sipas ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. 2. Pretendimet tjera të mundshme kreditore ndaj Ndërmarrjes Shoqërore Trepça të paraqitura deri në datën e vendosjes në likuidim të aseteve sipas nenit 14 të këtij ligji, trajtohen sipas ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit”*.

Në kuptim të dispozitave të lartcekura, rezulton që në lidhje me të gjitha detyrimet e krijuara nga ana e ndërmarrjes Trepça nën administrimin e AKP-së para hyrjes në fuqi të ligjit të lartcekur, të njëjtat duhet trajtuar në përputhje me ligjin Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ndërsa vetëm lidhur me kërkesat që lindin pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, procedura mund të zhvillohet ndaj shoqërisë aksionare Trepça Sh.a, kjo në përputhje me nenin 14, par.3 të Ligjit mbi Trepçën i cili parasheh se *“Prej hyrjes në fuqi të këtij ligji të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me Trepça SH.A. do të trajtohen në përputhje me ligjin për Ndërmarrjet Publike”*.

Në këtë drejtim, meqenëse kemi të bëjmë me propozim për përmbarim për realizimin e një kërkesë ndaj debitorit “Trepça Ndërmarrje nën Administrimin e AKP”, Gjykata iu referua neni 10, paragrafi 1 i saj të shtojcës së ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit i cili përcakton se *“Çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që përfshin apo që është kundër një ndërmarrje (apo aseteve të saj) që është subjekt i Vendimit për Likuidim pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidimit në gjykatën përkatëse, autoritetin publik apo tribunalin e arbitrazhit. Ky njoftim i referohet këtij neni 10 dhe shoqërohet me një kopje të Vendimit për Likuidim dhe një kopje të Njoftimit të publikuar për likuidim”*.

Në ndërlidhje me këtë, me nenin 277, par.1, pika (d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) i cili gjen zbatim përshtatshmërisht në këtë çështje përmbarimore në përputhje me nenin 17 të LPP-së përcaktohet se *“Procesi gjyqësor ndërpritet: d) kur paraqitet propozimi për fillimin e procedurës së falimentimit në kontestet në të cilat i padituri është debitor falimentues”*.

Referuar dispozitave të lartcekura, meqenëse debitor në këtë çështje përmbarimore paraqitet “Trepça Ndërmarrje nën Administrimin e AKP”, e në anën tjetër, kërkesa që buron nga dokumenti i besueshëm është bërë e arritshme para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 05-L-120 për Trepçën, e rrjedhimisht nuk ka kaluar si detyrim për subjektin Trepça Sh.a, atëherë rezulton se procedura në këtë çështje përmbarimore në kuptim të nenit 277, pika (d) duhet të ndërpritet, kjo për faktin se duke qenë në procedurë të likuidimit, debitori tanimë ka cilësinë e debitorit falimentues.

Andaj, konform nenit 10 të shtojcës së Ligjit 04/L-034 mbi AKP-në, nenit 17 të LPP-së në lidhje me nenin 277, pika (d) të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1537/22, datë 04.06.2024

Gjyqtari  
Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.